



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN

Nr. 1514 Prot. A.N

Laç me 26.02.2021

Z. Shkollu
S.M.K.S 207

LENDË: Dërgohet raporti vjetor i Prokurorisë për vitin 2020

Drejtuar

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

TIRANË

Bashkelidhur me shkresën ju dergojmë raportin vjetor të vitit 2020 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTUESI I PROKURORISË

ARBËN NIKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN

RAPORTI VJETOR
I PUNËS SË PROKURORISË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
KURBIN

PËR VITIN 2020

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, neni 50 i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë” është hartuar raporti vjetor i punës për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin për vitin 2020.

Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Kurbin, gjatë vitit 2020, kanë ushtruar funksionet e tyre në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Marrëveshjeve Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ligjeve proceduriale dhe ligjeve materiale në fuqi, duke patur prioritet respektimin e të Drejtave të Njeriut, në frymën e ndryshimeve ligjore të bëra në kuadër të reformës në drejtësi.

Prokurorët, Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe punonjësit e administratës së Prokurorisë Kurbin kanë vepruar në respektim të Marrëdhënieve Ndërinstitucionale, në respektim të Kodit të Etikës, si dhe në zbatim të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, duke treguar kujdes për ushtrimin sa më mirë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorit, forcimit të ligjshmërisë dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, duke treguar më shumë profesionalizëm dhe efikasitet në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Funksionet e prokurorit për vitin 2020, ashtu si dhe në vitin e kaluar, janë ushtruar duke u fokusuar dhe respektuar “pavarësinë e brendshme të cdo prokurori për hetimin dhe ndjekjen penale”.

Funksionet e prokurorit nga secili prokuror janë ushtruar në zbatim të ligjit si dhe duke u përpjekur që krahas objektivave të tjera për të rikthyer besimin e publikut të drejtësisë, në përmbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në këtë vit që po analizojmë gjatë punës sonë kanë gjetur aplikim me të shtuar dhe institutet e reja të parashikuara në kuadër të ndryshimeve që i janë bërë Kodit të Procedurës Penale, si urdhëri penal, gjykimi me marrëveshje, gjykimi i drejtpërdrejtë etj.

Gjithashtu nga ana e trupës së prokurorëve është bërë përpjekje për një përfaqësim sa më cilësor të prokurorit në këto gjykime.

Një rëndësi të veçantë si drejtues, i është kushtuar ushtrimit të funksioneve të secilit prokuror brenda kodit të etikës, duke mbikqyrur jo vetëm paraqitjen në seancë gjyqësore, në datën dhe orën e caktuar, mënyrën e komunikimit me trupin gjykues dhe palët në proces, respektimin e disiplinës në punë, garantimit të të drejtave të viktimës së veprës penale, etj.

Në funksion të përmbushjes së detyrave, rol të rëndësishëm ka mbajtur dhe administrata e prokurorisë e cila ka bërë të mundur përgatitjen e akteve dhe praktikave të fashikuara për në gjykatë, si dhe përmbushje një sërë detyrash të tjera që lidhen me punën e prokurorit, çfarë ka mundur të realizojë dhe përmbushjen në kohë të detyrave të prokurorisë.

Qëllimi kryesor i analizës vjetore të punës për vitin 2020, sikurse relatohet në vijim, është që të evidentojë të gjitha momentet pozitive dhe problematikave në punën e Prokurorisë Kurbin për periudhën 1 vjeçare viti 2020, në mënyrë që në vitin në vazhdim të përmirësohen këto tregues, duke synuar për rezultate edhe më të mira.

Ngarkesa që kanë përballuar në punë për këtë vit, të dhenat dhe treguesit e shënuar lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin në gjykim, vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore,

mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe ushtrimin e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj, tregojne për punë me ndenjë përgjegjësie, nga të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e kësaj prokurorie.

Rritja e cilësisë së hetimit, shkurtimi i afateve hetimore, zbatimi i instituteve të reja procedurale të së drejtës, unifikimi i praktikave, për çështje që nga pikëpamja e kualifikimit ligjor kanë gjetur zgjidhje të ndryshme në praktikën gjyqësore etj, na bëjnë që të synojmë përmirësimin e këtyre treguesve në vitin në vazhdim.

Në vijim me lejon të parashtrij, konkretisht treguesit e punës për vitin 2020, referuar të dhënave mbi punën e këtij institucioni, sa më poshtë vijon:

PERMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR

I. DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER KRIMINALITETIT:

- Respektimi i te drejtave te njeriut;
- Te miturit dhe grupet vulnerabel, si te pandehur dhe viktima.
- Bashkepunimi nderinstitucional.
- Bashkepunimin nderkombetar.
- Perdorimin e metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive.
- Informacion mbi zbatimin e Udhezimeve te Pergjithshme te Prokurorit te Pergjithshem.
- Informacion mbi zbatimin e rezolutes se Kuvendit dhe Planit te Veprimit ne zbatim te saj.
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve te Keshillit te Ministrave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem te nxjerra ne baze te tyre.
- Informacion statistikor mbi çeshtjet penale qe lidhen me procesin e verifikimit te Integritetit te Personave qe Zgjidhen, Emerohen ose Ushtrojne Funksione Publike.
- Te dhenat per temat dhe numrin e trajnimeve te prokuroreve dhe oficerëve te policise gjyqesore apo te perbashketa me Policine e Shtetit.
- Problematikat e hasura.

II. ANALIZA E TREGUESVE TE KRIMINALITETIT DHE PUNES SE PROKURORISE:

- Volumi i punes ne hetim.
- Te dhena ne lidhje me njoftimet per veprat penale.
- Treguesit kryesor te punes se prokurorise.
- Te dhena ne lidhje me masat e sigurimit.
- Çeshtje te perfaqesuara ne gjykate.
- Treguesit e ekzekutimit te vendimeve gjyqesore te formes se prere.
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale te njesive administrative ne kompetence te prokurorise.
- Kriminaliteti sipas peshes/perhapjes se veprave penale dhe tendencave te tyre dhe kriminaliteti sipas struktures se Kodit Penal (krime - kundervajtje).

III. TREGUESIT STATISTIKORE 2 VJEÇAR TE VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURES SE KODIT PENAL:

IV. ANALIZA E TREGUESVE TE EFEKTIVITETIT TE PUNES SE PROKURORISE:

- Treguesi i efektivitetit ne gjykimin dhe ne denimin e te pandehurve.
- Te dhena per gjykimet e posaçme.
- Te dhena mbi llojet dhe masat e denimeve.
- Te dhena sociale dhe demografike per te pandehurit.
- Te dhena per te pandehurit e mitur.

V. TE DHENA LIDHUR ME MARREDHENIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA:

- Ekstradime.
- Leterporosite.
- Njohjet e vendimeve penale.
- Transferimet e procedimeve penale.
- Transferimet e personave te denuar.
- Shpalljet ne kerkim nderkombetar dhe heqjet nga kerkimi.

VI. TE DHENA PER NGARKESEN E PUNES:

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISE:

- Zbatimi i buxhetit, marredheniet me median dhe publikun, etj.

VIII. DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER KRIMINALITETIT PER VITIN 2020 DHE REKOMANDIME.

I. DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER KRIMINALITETIT PER VITIN 2020

- **RESPEKTIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT**

Nga ana e Prokuroreve dhe Oficeret e Policise Gjyqesore ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin gjate vitit 2020, ne ushtrimin e funksioneve te tyre, rëndësi të veçante i kane kushtuar respektimit te te drejtave themelore te njeriut, duke respektuar parimet e proçedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, në mbrojtje të të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve dhe të dënuarve.

Me ndryshimet ligjore, Kodi i Proçedures Penale i ka dhënë statusin e subjektit të proçedimit penal viktimës së veprës penale. Në këtë aspekt, respektimi i të drejtave të viktimave të krimit në përgjithësi, dhunës në familje, dhunës seksuale, ndihma ndaj personave me aftësi të kufizuara kur janë pjesëmarrës në proçedim, etj kerkojne angazhim dhe rritje te profesionalizimit te prokuroreve dhe oficerëve te policise gjyqesore qe merren me ceshtje penale te kesaj natyre.

Nga ana e prokurorëve në procesin penal janë mbajtur parasysh vecanerisht të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve dhe detyrimet ndaj tyre, në kuadrin e ndryshimeve ligjore dhe risive që legjislacioni proçedural penal ka njohur. Prokuroret, oficeret e policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë kanë mbajtur në vëmendje nevojën për privatësi të viktimave dhe dëshmitarëve veçanerisht ne çeshtjet penale me te mitur.

Gjate ushtrimit te funksionit, permbushjes se detyres se tyre prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore kane vepruar ne perputhje me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Konventen per te Drejtat Themelore te Njeriut, si dhe ligje te tjera qe garantojne keto te drejta.

Gjate vitit 2020 nuk ka patur dhe nuk janë evidentuar raste të shkeljes apo cenimit të këtyre të drejtave.

Gjate të gjithave fazave të procesit penal janë respektuar të gjitha detyrimet proceduriale dhe ato që kanë lidhje me të drejtat e njeriut. Nuk ka patur zgjatje të pajustificuara të hetimit. Janë respektuar dispozitat proceduriale që parashikojnë të drejtat e paleve në procesin penal. Janë marrë në shqyrtim dhe vlerësuar kërkesat apo memot që palet kanë paraqitur gjatë hetimit paraprak.

Për vitin 2020 në Prokurorinë Kurbin nuk ka patur ndonjë Rekomandim të bërë nga Avokati i Popullit.

- **TE MITURIT DHE GRUPET VULNERABEL, SI TE PANDEHUR DHE VIKTIMA**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, nuk ka Seksion për Hetimin e Çështjeve Penale me të Mitur. Është i caktuar një Prokuror për trajtimin e kësaj kategorie çështjesh, por dhe janë vlerësuar nga Prokurorët e gatshëm sipas rastit.

Çështjet penale që kanë të bëjnë me të miturit në konflikt me ligjin, me të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprave penale, janë vlerësuar në mënyrë të veçantë, në respektim dhe zbatim dhe të Kodit për Drejtësi penale për të mitur.

Gjate vitit 2020 janë trajtuar dhe hetuar 15 proçedime penale ku të miturit janë në konflikt me ligjin.

Për 10 proçedime, nga ana e prokurorëve është vendosur pushimi i çështjes, duke aplikuar masa e shmangies nga ndjekja penale. 5 proçedime penale me 5 të pandehur, janë derguar për gjykim në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Kurbin.

Në çdo moment, çdo veprim hetimor procedural i kryer në lidhje me të miturin në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor, kordinatorit dhe psikologut.

- **BASHKEPUNIMI NDER INSTITUCIONAL.**

Objektivi kryesor i punës së prokurorisë mbetet rritja e efektivitetit të hetimit dhe vënia përpara përgjegjësisë penale e personave që shkelin ligjin. Përmbyshja e këtij objektivi varet jo pak nga bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e tjera ligjzbatuese me të cilat lidhet puna e prokurorisë. Në luftën kundër kriminalitetit bashkëpunimi dhe koordinimi është thelbësor në ngritjen e një çështje penale. Për këtë arsye forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional gjatë vitit 2020 për Prokurorinë Kurbin ka qenë prioritar.

Përgjatë gjithë vitit 2020, janë realizuar takime të përbashkëta me shërbimet e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhe, janë shkëmbyer informacione, janë mbajtur raporte korrekte me institucione dhe struktura ligjzbatuese, me të cilat lidhet ngushtë puna e prokurorisë, në zbatim të ligjit procedural penal dhe ligjit organik për prokurorinë.

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin, gjate vitit 2020, ka patur kryesisht marredhenie, por jo vetem, me:

- Prokurorine e Pergjithshme, dhe te gjitha drejtorite, e organizuara prane Prokurorise Pergjithshme;
- Strukturat e Policise se Shtetit, Drejtorine Vendore te Policise Lezhe dhe Komisariatin e Kurbin, qe ushtrojne funksionet ne territorin ku shtrin kompetencat Prokuroria Kurbin;
- Me te gjitha institucionet e tjera qe kane organizuar sherbime te policise gjyqesore, dhe kane referuar materiale hetimore ne Prokurorine Kurbin;
- Me Gjykatën e Shkalles se Pare Kurbin, per fazen qe lidhet me kerkimet e bera gjate hetimit paraprak, ne séance paraprake, me perfaqesimin e akuzes ne gjykim, etj;
- Me Prokurorine dhe Gjykatën e Apelit Tirane, per fazen qe lidhet me çeshtjet penale te ankimuara;
- Me IEVP – Shenkoll, Lezhe,
- Me Zyren e Sherbimit te Proves Kurbin;
- Me Zyren e Permbarimit Kurbin.
- Me Institucione te tjera ne nivel lokal.

- **RAPORTET ME PROKURORINE E PERGJITHSHME. ZBATIMI I UDHEZIMEVE TE PROKURORIT TE PERGJITHSHEM.**

Gjate vitit 2020 vleresoj se ka patur nje bashkepunim mjaft te mire me te gjitha Drejtorite ne Prokurorine e Pergjithshme. Ky bashkepunim i ka sherbyer punes se perditshme, permiresimit te parametrave tregues dhe realizimit te objektivit te veprimtarise ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin.

Ndryshimet ligjore ne aspektin e organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, ligjet e tjera të reformës në drejtësi të miratuara gjatë viteve 2016 - 2017, kane çuar ne ndryshime te ndjeshme, per zbatimin e unifikuar te te cileve nga prokurorite ishte domosdoshmeri nxjerrja e udhezimeve te pergjithshme.

Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm kanë orientuar dhe normuar punën e përditshme. Këto Udhëzime i kanë shërbyer zbatimit uniform të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kanë qenë një ndihmë për të unifikuar zbatimin e ligjit, duke patur në konsiderate faktin që në një sere ligjesh që zbatohen në punën e përditshme të prokurorit ka patur ndryshime të karakterit thelbësor.

Këto Udhëzime kanë kontribuar në forcimin e ligjshmërisë dhe efektivitetit te punës së përditshme të prokurorëve. Prokuroret dhe Oficeret e Policise Gjyqesore kane vepruar ne perputhje me sa udhezohet ne Udhëzimet e Pergjithshme te Prokurorit te Pergjithshem.

Ne Prokurorine Prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin, Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm jane zbatuar drejtperdrejti, pa nxjerrë udhëzime të përgjithshme te brendshme ne zbatim te tyre nga ana e drejtuesit te Prokurorise.

- **RAPORTET ME STRUKTURAT E POLICISE SE SHTETIT.**

Gjate vitit 2020 qe po analizojmë, bashkepunimi me te gjitha strukturat e policise se shtetit, ne Qarkun e Lezhes, si Drejtoria Vendore e Policise se Qarkut Lezhe, dhe Komisariati i Policise Kurbin, ka qene mjaft i mire.

Ne kuader te ketij bashkepunimi eshte mundesuar respektimi me rigorozitet i detyrimeve ligjore ne funksion te rritjes se cilesise dhe shpejtesise se hetimit paraprak. Jane realizuar takime periodike dhe analiza të përbashkëta me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, qofte ne nivel drejtuesish institucionesh, shut dhe nga prokuroret me perfaqesues te seksioneve te caktuara ye policise gjyqesore. Pjesa me e madhe e procedimeve penale jane rregjistruar mbi bazen e materialeve hetimore te referuara nga sherbimet e policise gjyqesore te Policise se Shtetit Komisariati i Policise Kurbin dhe Drejtoria Vendore e Policise Lezhe.

Si rregull veprimet hetimore, prej prokuroreve te ngarkuar me hetimin e ketyre çeshtjeve penale, jane deleguar tek oficeret e policise gjyqesore, te sherbimeve perkatese. Ne disa raste kur ka patur levizje te oficerëve te policise gjyqesore ne detyre, apo per oficere te policise gjyqesore qe ushtrojne detyren me kohe te pjesshme, delegimi i veprimeve hetimore eshte bere tek oficeret e policise gjyqesore te Seksionit te Prokurorise.

Ka ndryshim ne drejtim te rritjes se cilesise dhe niveli i hetimeve paraprake te kryera nga sherbimet e policise gjyqesore. Materialet hetimore, me veprime te ngutshme, referohen ne kohe. Po keshtu ka patur koordinim te mire ndermjet prokuroreve dhe oficerëve te policise gjyqesore, ne aspektin e te vepruarit ne kohe, ne rastet e hetimeve proaktive.

Mbetet problem lëvizjet e shpeshta të oficerëve të policisë pranë shërbimeve të policisë gjyqësore, azhurnimi i tyre ne vijimsi me legjislacionin e ndryshuar procedural penal dhe ndryshimet e tij, si dhe numri i tyre gjithmonë nën organikën e parashikuar, faktorë të cilët ndikojnë direkt në cilësinë e materialeve të referuara dhe në shpejtësinë e hetimit.

- **RAPORTET ME GJYKATEN E SHKALLES SE PARE KURBIN**

Raportet me Gjykatën e Shkalles se Pare Kurbin kane qene korrekte dhe ligjore, ne te gjitha fazat e perfaqesimit te prokurorise ne gjykim. Keto raporte korrekte dhe ligjore shfaqen si ne kerkesat qe lidhen me fazen e hetimit paraprak, tek gjyqtari i séances paraprake, ne perfaqesimin e akuzes ne gjyq, ne gjykimin e procedimeve penale, si dhe ne gjykimet ku objekt jane kerkesat ne fazen e ekzekutimit te vendimeve penale. Prokuroret kane respektuar me korrektese pjesemarrjen ne gjykim, nuk ka patur shtyrje apo zvarritje te pajustificuara te proceseve gjyqesore, me perjashtim te seancave gjyqesore, per te cilat kane patur perplasje ne orar. Nga prokuroret eshte respektuar e solemniteti ne gjykim.

- **RAPORTET ME PROKURORINE E APELIT TIRANE**

Me Prokurorine e Apelit Tirane ka patur nje komunikim te vazhdueshem, ne funksion te perfaqesimit sa me cilesor te akuzes ne ceshtjet e ankimuaara. Si rezultat i nje komunikimi te tille eshte bere e mundur qe te njihen dhe trajtohen me mire problematikat qe lidhen me perfaqesimin e akuzes ne çeshtjet e ankimuaara.

Nga ana jone eshte vazhduar ndjekja e praktikes se vendosur qe apelimet e prokuroreve te shkalles se pare, si per masat e sigurimit dhe per vendimet perfundimtare, krahas depozitimit ne gjykatën Kurbin dergohen paralelisht per njoftim edhe ne Prokurorine e Apelit Tirane.

- **RAPORTET ME GJYKATEN E APELIT TIRANE.**

Raportet e Prokurorise Kurbin me Gjykatën e Apelit Tirane kanë qenë tepër të kufizuara, pasi përfaqësimi i akuzës në Gjykatën e Apelit është kryer nga Prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tirane.

- **RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA VENDORE.**

Është bashkëpunuar me institucione të tjera si Prefektura Lezhe, Bashkinë Kurbin, në aktivitete që i shërbejnë parandalimit të përhapjes së veprave penale, sikurse janë ato në fushën e kultivimit dhe shpërndarjes së lendeve narkotike, dhunës në familje etj. Është bashkëpunuar me I.E.V.Penal Shenkoll Lezhe lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale.

- **BASHKEPUNIMI NDERKOMBETAR**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin gjatë vitit 2020 ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjen nga kerkimi, në lidhje me leterporosi të mbërritura nga jashtë shtetit dhe të nisura për jashtë shtetit, ekstradimet, njohjet e vendimeve penale të huaja etj.

- **PERDORIMI I METODAVE SPECIALE TE HETIMIT DHE HETIMET PROAKTIVE.**

Në luftën kundër kriminalitetit, organi i prokurorise është angazhuar maksimalisht në përdorimin e metodave speciale hetimore dhe në ndërmarrjen e hetimeve proaktive, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet e tjera ligjzbatuese.

Jane filluar disa çështje penale në baze të informacioneve duke përdorur metoda speciale të hetimit, hetime proaktive, kryesisht përgjimi dhe vëzhgimi, për hetimin e veprave penale kundër korrupsionit, narkotikeve si dhe për hetimin e krimeve kundër jetës, të kryera me dashje.

- **INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE REZOLUTES SE KUVENDIT TE SHQIPERISE DHE TE KESHILLIT TE MINISTRAVE**

Gjatë vitit 2020, në punën e përditshme të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, kanë gjetur zbatim Rekomandimet Prioritare “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”, miratuar nga Këshilli i Ministrave si dhe të Rezolutes së Kuvendit të Shqipërisë dt 18.06.2020. Ka patur një bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe me agjensitë e tjera ligjzbatuese. Ka patur një rritje të hetimeve proaktive dhe përdorim të teknikave speciale të hetimit, përmirësim të cilësive të hetimit.

Sa i përket masave administrative për nxjerrjen e një udhëzimi të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimit të një plani veprimi për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të rezolutes, është organizuar mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë Kurbin për marrjen e mendimeve dhe sygjërimeve të prokurorëve për masat eventuale dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Sa i përket çështjeve penale që mund të jenë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme, referuar formave të veçanta të bashkëpunimit, nga nga të dhenat e disponuara rezulton se përgjatë këtij viti, nuk ka pasur procedime penale të cilat të jenë dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme

per kete shkak. Nderkohe jane derguar per kompetence lendore 3 proçedime penale rregjistruar per kryerjen e veprës penale te parashikuar nga neni 244 e 259 te K.Penal, akte keto te pranuar nga Prokuroria e Posaçme.

Lidhur me raporte, analiza, akte të përbashkëta, trajnimet, që kanë për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale, ndjekjen e hetimeve pasurore, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, është, prokuroret kanë qenë pjesë e programeve të trajnimit dhe seminareve të zhvilluara, për rritjen e kapaciteteve profesionale në luftën kundër pastrimit të parave e produkteve të veprimtarisë kriminale, krimit financiar dhe hetimeve pasurore.

Per periudhen objekt raportimi, nuk ka patur shkembime informacioni apo skuadra hetimore te perbashketa, ne kuader te bashkepunimit nderkombetar.

Përgjatë kësaj periudhe nuk ka pasur hetime paralele për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale krahas veprave të tjera penale.

— Janë rregjistruar gjithsej 26 hetime pasurore, ndërsa nuk ka hetime financiare dhe sekuestro/konfiskime në vijim të këtyre hetimeve.

Me caktimin e një prokurori me ndjekjen dhe hetimin e veprave penale në fushën e pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale, çmuj se është e nevojshme zhvillimi i trajnimeve për studimin e thelluar të praktikave dhe metodikave të hetimit efikas të këtyre veprave penale.

Lidhur me trajtimin e viktimave të veprës penale, në zbatim edhe të udhëzimit nr. 5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, sqarojme se ky është një fokus i përditshëm në punën e prokurorëve. Ndhima ndaj viktimave realizohet edhe në bashkëpunim me shërbimet e policisë dhe organizmat vendore që kanë si objekt trajtimin e viktimave të veprës penale. Në këtë drejtim një rendesi dhe trajtim te vecantë i kushtohet të miturve, për të cilët edhe në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, janë ngritur dhe funksionojnë normalisht edhe organizmat vendore që ndihmojnë në trajtimin më konkret të këtyre rasteve.

Sa i përket aspektit proçedural, viktimat e veprës penale janë asistuar në të gjitha fazat në përputhje me garancitë që ofron kodi i proçedurës penale, duke zhvilluar çdo veprim hetimor me pjesëmarrjen e psikologut, si dhe duke mundësuar kontaktin e viktimës me koordinatoren e viktimës ne Prokurori. Lidhur me koordinatoren, duke qenë se është një pozicion i ri në prokurorinë shqiptare, por pa qenë një pozicion i qarte proçedural, sipas kodit të proçedurës penale, është e nevojshme që të saktësohet dhe orientohet peshkrimi konkret i detyrave dhe i përgjegjësive të këtij subjekti.

Konstatohet se përgjatë hetimeve janë respektuar të drejtat e të pandehurve apo personave nën hetim, vecanërisht është mbajtur në konsideratë e drejta e mbrojtjes. Në këtë drejtim, duhet përmendur se është ndjekur një politikë e kujdesshme penale, vecanërisht në masat e sigurimit dhe dënimet përfundimtare. Janë bërë përpjekje për kufizimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit me arrest në burg dhe dënimet përfundimtare me burgim, duke i aplikuar këto masa në rastet e veprave penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si vepra penale të dhunës në familje, ato kundër fëmijëve si ngacmime seksuale, etj.

Nga Prokuroria Prane Gjykes se Shkalles se Pare Kurbin, për vitin 2020 janë rregjistruar 10 proçedime penale per vepren penale te parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, 2 proçedime për vepren penale te parashikuar nga neni 244 të Kodit Penal, 1 proçedim per vepren penale te parashikuar nga neni 259 i K.Penal, 20 proçedime per vepren penale te parashikuar nga neni 283 të Kodit Penal, 13 proçedime per vepren penale te parashikuar nga neni 284 të Kodit Penal, 1

proçedime per vepren penale te parashikuar nga neni 141/a dhe 4 proçedime per vepren penale te parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal.

Per kete grup veprash penale është vendosur dërgimi për gjykim per 4 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal me 4 te pandehur, i 9 çështjeve për nenin 283 të Kodit Penal me 10 te pandehur, 1 çështje penale per vepren penale te parashikuar nga neni 287/b te K.Penal me nje te pandehur dhe eshte shpallur moskompetence per 3 çështje per vepren penale te parashikuar nga neni 244 dhe 259 i K.Penal, me 3 te arrestuar.

Lidhur me rastet e referuara për nenin 287 të Kodit Penal, jane rregjistruar nga ana jone gjate vitit objekt analize 4 proçedime penale, është proçeduar me hetime sistematike dhe te thelluara pasurore me qëllim evidentimin e pasurive të vëna nga aktiviteti i kundraligjshem dhe në kuadër të provueshmërisë së burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasuri.

Sa i perket hetimit te kesaj kategorie vepre penale, hasen vazhdimisht veshtiresi dhe problematika te lidhura keto me dokumentimin e faktit, evidentimin e pasurive, veprimeve te kryera nga personat e dyshuar ne shtete te tjera etj.

Referimet e para te policise gjyqesore, konstatohen se jane te paplota, formale dhe te pa shoqeruara me minimumin e verifikimit te pasurive ne lidhje me sa referohet.

Evidentohen te dhena te disponuara prej policise gjyqesore, apo te nxjerra nga sistemet e policise se shtetit lidhur me kerkimet e shtetasve nga autoritetet e huaja, pa verifikuar aktivitetin e tyre kriminal/ tendencat ne Shqiperi apo dhe jashte si dhe pasurite qe disponojne ne territorin Shqiptar.

Te dhenat e relatuara per pasurite e disponuara nga te dyshuarit, nuk shoqerohen me minimumin e akteve qe provojne pronesine apo posedimin e tyre.

Veshtiresi ne hetimin e kesaj vepre penale, sjell ne menyre te drejtperdrejte informalitetin e në shoqërinë shqiptare. Veprimtaria tregtare eshte kryer ne menyre informale, duke mos lene gjurme dhe lidhje me aktivitetin e mundshem kriminal.

Hetimet e kesaj vepre penale nga policia gjyqesore kryhen vetëm nëpërmjet verifikimit pasuror, pra duke kërkuar të dhëna nga institucione bankare, subjekte ku rregjistrohen pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të shtetasve dhe personave juridikë, pa u shoqeruar me te dhena apo fakte te dokumentuara nga policia gjyqesore ne terren ku ndodhen apo pretendohen te jene keto pasuri.

Kërkimi i të dhënave institucioneve te ndryshme ekspozon hetimet dhe cënon sekretin e tyre. Përpyekjet janë në drejtim të përdorimit të metodave të tjera hetimore, përgjime ambientale e telefonike, nëpërmjet filmimit e regjistrimit, sigurimi i të dhënave për pasuri që mund të jenë regjistruar në emër të shtetasve të tjerë pa lidhje familjare me subjektin;


Një problem janë dhe Letërporositë me shtetet e tjera. Vonesa për shkak të kërkesave për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të shteteve të huaja, me anë të të cilave kryesisht janë kërkuar të dhëna mbi personat nëse janë të evidentuar si persona me precedentë kriminalë apo edhe për administrim provash.

Pa anashkaluar mangesite e konstatuara ne hetimin e dokumentimin e kesaj vepre nga policia gjyqesore, vleresojme te relatojme dhe faktin e ngarkeses se madhe ne pune te prokuroreve per te trajtuar me rendesine maksimale te kesaj vepre penale.

Per shkak te specifikes se kesaj vepre, nga ana e Prokurorit kerkohet impenjim maksimal dhe trajnim i vazhdueshem. Numri i vogel i Prokuroreve dhe ngarkesa e punes, kane passjelle dhe zvarritje ne hetimin e kesaj vepre penale.

Per shkak te natyres se hetimit keto proçedime jane ne hetime dhe nuk kane perfunduar gjate vitit qe po analizojme.

Viti	Neni 244/259	Neni/248	Neni/283	Neni /284	Neni/287	Neni 141/a
2019	3	11	18	16	11	2
2020	3	10	20	13	4	2



Gjatë vitit 2020 në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit janë shkënbyer informacione, si dhe nga ana e tyre janë referuar në prokurori disa materiale hetimore në fushën e trafikeve të paligjshme, kryesisht narkotikëve si dhe në fushën e grupveprave të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës etj.

Me qëllim evidentimin dhe kapjen në flagrancë të autorëve të dyshuar të këtyre veprave penale janë kryer veprime hetimore me metoda speciale të hetimit ku në disa raste janë lëshuar autorizime përgjimi, ambientale por edhe telefonike si dhe autorizime vëzhgimi nga prokurori të cilat në disa raste kanë dhënë rezultat duke bërë të mundur arrestimin në flagrancë të autorëve, autorizime të cilat janë vlefshme të ligjshme nga gjykata.

Jane vlerësuar gjatë vitit 2020 drejt kushtet dhe kriteret e vendosjes së masave të sigurimit, kërkesat për masat e denimit në gjykim, në përputhje me këto rekomandime të Këshillit të Ministrave.

Ka një ashpersim të politikës së denimit për grup vepra penale kryesisht vepra penale të dhunës në familje, mbajtjes pa leje të armëve, krimeve kundër personit, kultivimit dhe shpërndarjes së narkotikëve si në kërkesat për masa sigurimi ashtu dhe në masën e denimit të kërkuar.

- **INFORMACION STATISTIKOR MBI ÇESHTJET PENALE QË LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TË INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMEROHEN, OSE USHTROJNE FUNKSIONE PUBLIKE.**

Në vitin 2020, nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në Prokurorinë Kurbin nuk është referuar kallezim penal.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Prokurorinë Kurbin nuk janë referuar kallezime penale.

Nga Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, këtë vit nuk është referuar kallezim penal.

• PROBLEMATIKAT E HASURA

Një problematikë e evidentuar në raport me Policinë, pra shërbimet e Policisë Gjyqësore, janë lëvizjet e shpeshta të oficerëve. Ka raste të zëvendësimit në një procedim penal të disa oficerëve të Policisë Gjyqësore. Kjo për shkak të lëvizjeve të shpeshta nga një sektor në tjetrin, ka raste që dosjet janë sjellë në prokurori pas 1-muaji nga lëvizjet, pa relacion etj.

Materiale e para procedurale të referuara kane mangesi, pa kryer verifikimet e plota duke veshtiresuar vendimmarrjen brenda afateve 15 ditore lidhur me mosfillimin apo rregjistrimin e procedimit penal.

Janë të shpeshta rastet kur nuk respektohet afati i lënë nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore, ku në lidhje me këtë problematikë është kërkuar rritja e kontrollit nga Prokuroret që ndjekin hetimin. Ajo që duhet evidentuar si mangësi është mos trajtimi i rasteve të shkeljeve duke kaluar në procedim disiplinor Of/Pol/Gjyqësore. Gjatë dinamikës së punës në hetimin e çështjeve shpesh evidentojmë të meta dhe mangësi, që janë trajtuar duke tërhequr vëmendjen.

Gjithashtu, gjate vitit objekt analize evidentohet dhe rritja e numrit te zgjatjes se afatit te hetimeve. Si shkak per zgjatje te hetimit ka sherbyer edhe vonesa ne mberritjen e akteve te ekspertimit kriminalistik, mjeko ligjor, kimik apo pergjigjeve te kerkuara nga shoqerite e telefonise celulare, por pa anashkaluar dhe mungesat e theksuara ne organiken e Prokurorise me prokurore duke sjelle mbingarkese reale te tyre ne hetim.

Problematike ne vetvehte perbejne dhe referimet jo te plota te vepres penale nga oficeret e policise gjyqesore, mosnjoftimi i prokuroreve per ngjarjet e ndodhura, marrja jo e sakte e gjeneraliteteve te subjekteve ne procedim, adresave etj.

Vihen re, raste referimi per kryerjen e veprave penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale", neni 287 i Kodit Penal, te paplota, pa kryer nje minimum verifikimi ne lidhje me sa referohet, pasurite e relatuara, vendndodhjen e tyre, apo dhe tendencat e preçedencat kriminale te personave te dyshuar.

Ndryshimet ne Kodin e Procedures Penale, si dhe ligjeve te tjera ne kuader te reformes ne drejtesi kane bere qe puna administrative e prokurorit te rritet ndjeshem.

Ne kuader te ndryshimeve ligjore nuk jane realizuar trajnime te oficerëve te policise gjyqesore me qellim rritjen e profesionalizimit si dhe pershtatjes se tyre me ndryshimet e reja.

II. ANALIZA E TREGUESVE TE KRIMINALITETIT DHE TE PUNES SE PROKURORISE:

Ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin gjate vitit 2020 kane ushtruar funksionet e tyre 3 prokurore dhe 2 oficeret e policise gjyqesore. Konkretisht Prokurori Arben Nika, Prokurori Bardhyl Shehu dhe Prokurore Ajola Prenci.

Shërbimet administrative në Prokurorinë prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin dhe shërbimet ndihmëse kryhen nga nëpunës dhe punonjës të tjerë, numri i të cilëve është 6 persona per gjithë strukturën e Prokurorisë.

Çeshtjet penale jane ndare me short elektronik, dhe ne periudha kohore te veçanta per shkak te problemeve ne sistemin CAMS, apo dhe me urdher te drejtuesit per balancimin e ngarkeses, me short manual. Jane ndare sipas grafikut te gadishmerise vetem çeshtjet penale me veprime te ngutshme dhe persona te arrestuar. Zevendesimet e Prokuroreve dhe Oficereve te policise gjyqesore, gjate ketij viti, kane qene te pakta dhe vetem per shkaqe ligjore. Bazuar ne urdhezimin e Prokurorit te Pergjithshem çeshtjet penale me persona te arrestuar ne flagrance jane marre direkt nga prokurori i gatshem pa iu nenshtruar shortit elektronik.

Po keshtu ne varesi te ngarkeses se Prokuroreve ne periudha te ndryshme eshte urdheruar dhe ndarja e çeshtjeve penale me short manual, ne menyre dhe qellim balancimin e ngarkeses si dhe perfshirja e Drejtuesit ne hetime.

Referuar te dhenave qe do t'ju paraqesim dhe analizojme ne kete raport vjetor, evidentohet se gjate vitit 2020, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin, ka perballuar nje ngarkese te madhe. Numri i referimeve, kallezimeve penale ne total eshte pothuaj njelloj si viti paraardhes, ndersa numri i proçedimeve te rregjistruara eshte me i larte.

Ndryshimet në Kodin e Proçedurës Penale kane bere qe puna e prokurorit të shkallës së pare kete vit te shtohet ndjeshëm. Eshte dyfishuar koha e Prokurorit ne Gjykate ne perfaqsimin e kerkesave "Per dergim çeshtje ne gjyq", "Kerkesa per gjykim", "Kerkesa per pushimin e çeshtjes penale", ankimime te ndryshme, duke reduktuar ne kete menyre kohen efektive te Prokurorit per hetimin e çeshtjeve dhe zgjidhjes se tyre ligjore.

TREGUESIT KRYESOR TË PUNËS SË PROKURORISË PËR VITIN 2020:

Gjate 2020, Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin ka administruar 800 kallezime, referime per vepra penale dhe materiale te tjera te ardhura nga policia e shtetit, nga shtetas te ndryshem, nga prokurori te tjera etj.

Te gjitha referimet jane regjistruar ne Rregjistrin e kallezimeve Penale, jane hedhur ne short dhe u kane kaluar menjehere per veprim prokuroreve, per vleresim dhe disponimin ligjor te metejshem. Prokuroret pasi kane studiuar faktin objekt referimi dhe aktet e administruara ne keto kallezime dhe referime, per 478 kallezime kane urdheruar rregjistrimin e proçedimit penal, pasi kane gjetur kushtet ligjore te parashikuara nga neni 287 i Kodit te Proçedures Penale.

Gjate vitit 2020, jane ndjekur ne hetim edhe 239 proçedime penale te mbartura nga nje vit me pare, pra nga viti 2019. Jane rifilluar 84 proçedime penale relatuar nga policia gjyqesore per efekt parashkrimi te ndjekjes penale. Gjate ketij viti kane ardhur me transferim nga prokurori te tjera edhe 15 procedime penale, dhe ne total numri i procedimeve te ndjekura ne hetim per vitin 2020 rezulton te jete 815 proçedime penale.

Gjate vitit qe po analizojme, nga prokuroret eshte perfaqesuar akuza ne gjykim per nje numer te madh proçedimesh penale, duke u perfunduar gjykimi ne Gjykatën Kurbin per 187 çeshtje penale.

Keto jane treguesit e volumit te punes qe eshte perballuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kurbin gjate vitit 2020. Nese keta tregues, do ti krahasonim me ato te nje viti me pare, pra me vitin 2019,

do te konstatojme se kemi nje gjendje pothuaj te njejte treguesish per sa i perket numrit te kallezimeve (lehtesisht me te ulet) dhe me te larte te proçedimeve penale te rregjistruara dhe te ndjekura ne hetim ne keto dy vite.

Gjate vitit 2020, siç theksuam edhe me lart, eshte bere rregjistrimi ne Regjistrin e Kallezimeve Penale per 800 kallezime dhe referime, ndersa per vitin 2019 jane regjistruar 820 kallezime.

Ne regjistrin e Proçedimeve Penale, gjate vititi 2020 jane regjistruar 478 proçedime penale, ndersa per vitin 2019 u regjistruan 470 procedime penale.


Gjate vitit 2020 perfshire dhe çeshtjet e mbartuar nga viti i meparshem, jane ndjekur ne hetim ne total 815 proçedime penale, ndersa per vitin 2019 jane ndjekur ne total 644 proçedime penale.

Edhe treguesi i perfaqesimit te akuzes ne gjykim rezulton te jete pothuaj i njejte me ate te nje viti me pare. Gjate vitit 2020 perfundoi gjykimi i 187 çeshtjeve penale, ndersa gjate vitit 2019 perfundoi gjykimi i 180 çeshtjeve penale.

Tabela me poshte pasqyron keta tregues sipas zerave qe trajtuam me siper per dy vitet, per vitin 2019 dhe vitin 2020.

Vitet	Kallezime	Mbartur proced	Regjist. proc	Ardhur me transf	Rifilluar	Gjithsej proced	Përf. gjykimi
2019	820	241	470	5	-	644	180
2020	800	239	478	15	84	815	187

Ndersa ne menyre grafike do te kishim kete paraqitje per volumin e punes te ndjekur ne dy vitet, 2019 dhe 2020.



Ne vitin 2020 është vendosur mosfillimi për gjithsej 307 kallelime penale. Ky tregues i krahasuar me atë të një viti më parë rezultoi të jetë më i lartë, pasi gjatë vitit 2019 mosfillimi i procedimit penal është vendosur për 257 kallelime penale, pra 50 vendime mosfillimi më shumë gjatë vitit 2020.

Trajtimi i kësaj zgjidhje ligjore mendoj se meriton vëmendje pasi për shkak të normimit të afatit 15 ditor për vendosjen e mosfillimit për kallelimet penale, problemi i administrimit të akteve të ndryshme, vecanërisht atyre mjekoligjore, kimike, autoteknike etj. kërkon trajtim dhe zgjidhje nderinstitucionale. Kjo për faktin se në këto procese hyjnë dhe nderveprojne disa institucione.

Kur nga materiali fillestar i referuar apo kallelimi drejtperdrejt i qytetarit nuk kanë rezultuar elemente të mjaftueshëm për fillimin e çështjes penale, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë kryer verifikimet paraprake (duke synuar respektimin e afatit kohor), pas të cilit, nëse nuk siguroheshin të dhëna të tjera, është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Gjatë vitit 2020, është kërkuar në gjykatë dhe vendosur nga ana jone pushimi i procedimit penal për 206 procedime penale.

Krahasuar me treguesin e një viti më parë, rezultoi se gjatë vitit 2020 kjo zgjidhje është vendosur për më shumë procedime. Gjatë vitit 2019 pushimi i hetimeve është vendosur për 66 procedime penale.

Evidentohet rritje e numrit të çështjeve penale të rregjistruara, pas kalimit të afatit 15 ditor pasi ka rezultuar e nevojshme administrimi i akteve të ekspertimit (mjekoligjor, autoteknik, piroteknik etj), në mënyrë për të disponuar dhe zgjidhur drejt rastet, ku më pas është konkluduar nga ana e prokurorëve me kërkesa drejtuar gjykates për pushim çështje apo vendime pushimi.

Ndikim direkt në shtimin e numrit të çështjeve penale të pushuara, ka rifillimi i 84 procedimeve penale të raportuara nga shërbimet e policisë gjyqësore të Komisarariatit të policisë Kurbin, ku pas rifillimit është kërkuar dhe vendosur pushimi i tyre në Gjykatë.

Gjatë vitit 2020, është vendosur pezullimi i hetimeve për 180 procedime penale, për shkak se pas hetimit të kryer për këto procedime penale, nuk është bërë e mundur të identifikohen autorët e veprave penale.

Krahasuar me një vit më parë, kjo zgjidhje ligjore rezultoi të jetë 25 procedime më shumë. Gjatë vitit 2019 pezullimi i hetimeve është vendosur për 155 procedime penale.

Nëse këto tregues do të analizojmë duke e krahasuar me numrin e procedimeve penale që kanë marrë zgjidhje për vitin 2019 edhe për vitin 2020, do të vëmë re se ky numër është më i lartë.

Gjatë vitit 2019 kanë marrë zgjidhje 409 procedime penale dhe nga këto për 132 procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve.

Ndërsa për vitin 2020 objekt analize, pezullimi i hetimeve është vendosur për 180 procedime penale nga 611 procedime që moren zgjidhje në këto vit.

Natyrisht që ky tregues meriton vlerësim dhe trajtim të posaçëm si nga në prokurorët që ndjekim hetimin, ashtu edhe nga policia gjyqësore e strukturave të policisë së shtetit që ndjek hetimet e procedimeve penale.

Treguesi i procedimeve penale të pezulluara është treguesi i zbulueshmerisë së krimit, i cili përveç tjerash ka edhe një impakt të ndjeshëm në shoqëri, pasi prek direkt qytetarët e demtuar dhe të cenuar ekonomikisht, fizikisht në shëndet dhe në jetën e tyre apo të familjarëve të tyre nga veprat penale.

E ngritem kete problem nisur edhe nga nje tregues tjetër, ai i rifillimit të proçedimeve penale për shkak se janë gjetur të dhëna që identifikojnë autorin e veprës penale. Gjate vitit 2020 ka patur vetëm 2 raste rifillimi për kete shkak.

Gjate vitit 2020, prokurorët kanë konstatuar moskompetencën për hetimin e 7 proçedimeve penale, prandaj dhe kanë vendosur kalimin e akteve për keto proçedime prokurorive të tjera.

Gjate vitit 2020, prokurorët e Prokurorisë Kurbin kanë vendosur dergimin në gjykate për 218 proçedime penale, nga 197 proçedime penale që u derguan për gjykim gjate vitit 2019. Pra, sic shihet ky tregues ka rritje të lehtë kete vit, me 21 proçedime më shumë.


Por lidhur me kete tregues duhet të sqarohet se ndryshimet e Kodit të Proçedurës Penale kanë ndikuar në kete drejtim, pasi kjo zgjidhje tashme rezultoi të paraqitet me e vonuar nga mbyllja e vitit kalendarik. Kjo për faktin se shumë kërkesa të derguara nga prokurorët në gjykate për dergimin në gjykim të proçedimeve penale, nuk u shqyrtuan brenda muajit dhjetor të vitit 2020 edhe pse në gjykate kërkesat u administruan brenda atij viti. Gjithashtu, evidentohet se dhe numri i proçedimeve penale të rregjistruara në teresi për vitin 2020 është më i lartë se ai i vitit 2019.

Nga viti 2020, u mbarten në hetim 204 proçedime penale nga 239 proçedime penale që ishin mbartur nga viti 2019.

Lidhur me kete fakt, vleresoj të ndalem për të sqaruar faktin se, funksionet e Prokurorisë Kurbin për vitin 2020, hetimet, perfaqesimin në gjyq dhe ekzekutimet i kanë ushtruar 3 prokurorë, Drejtuesi i Prokurorisë Arben Nika dhe Prokurori Bardhyl Shehu dhe Prokurorja Ajola Prençi.

Tabela pasqyron zgjidhjet e dhëna për vitin 2020 e krahasuar edhe me ato të dhëna për vitin 2019.

Vitet	Mosfillim	Pushim	Pezullim	Transf	Gjykate	Perfund/ Proced	Mbartur
2019	257	47	155	6	197	405	239
2020	307	206	180	7	218	611	204



EFEKTIVITETI I NDJEKJES PENALE DHE PERFAQESIMIT TE AKUZES NE GJYKIM GJATE VITIT 2020.

Per vitin 2020, numrin me te madh te kallezimeve e ka referuar policia e shtetit. Nga ky subjekt, Komisariati i Policise Kurbin dhe Drejtoria Vendore e Policise Lezhe, per vitin 2020 jane referuar 758 kallezime ose 94.7 % e te gjithë kallezimeve qe u regjistruan ne kete vit.

Kallezimet e referuara nga policia e shtetit gjate vitit 2020 jane per vepra te ndryshme penale te kryera ne rrethin e Kurbin.

Referimet e ketij subjekti jane per vepra penale me vendngjarje, per fakte dhe ngjarje te ndryshme per te cilat ky subjekt ka ardhur ne dijeni, si dhe per ngjarje e fakte te kallezuar nga shtetas te ndryshem prane ketij subjekti.

Gjate vitit 2020, ne prokurori jane administruar 32 kallezime penale nga shtetas te ndryshem, me objekt kryesisht konfliktet e pronesise mbi token. Edhe pse ky numer ne raport me numrin e pergjithshem te kallezimeve dhe te materialeve qe jane referuar per kete vit ne prokurori, perben vetem 4 % te tij, eshte per tu vleresuar si rritje e besimit te qytetareve tek prokuroria si organ i ndjekjes penale.

Edhe statistika e vitit 2020 lidhur me kallezimet dhe referimet nga policite e tjera gjyqesore dhe nga institucionet e ndryshme shtetore eshte e njejte me ate te disa viteve me pare. Kallezimet nga keto subjekte vazhdojne te mungojne. Ne statistike evidentohen vetem 10 kallezime nga nepunesit publik, ku 8 prej tyre jane nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, dy nga Zyra Permbaremore-Kurbin.


Referimet dhe kallezimet e ndryshme, ne çdo rast, jane vleresuar me vemendje dhe seriozitet nga prokuroret dhe mbi gjendjen e akteve eshte orjentuar edhe trajtimi i tyre.

Gjate vitit objekt analize, ne lidhje me 307 kallezime dhe referime, siç parashtruam edhe me siper, prokuroret pasi kane administruar aktet e nevojshme dhe kane kryer veprimet e nevojshme verifikuese, kane vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi kane gjetur kushtet ligjore te parashikuara nga neni 290 i Kodit te Proçedures Penale.

Nese do ti shikonim mosfillimet sipas grup veprave per te cilat jane referuar materialet, pa hyre ndarjeve sipas krereve te K.Penal, numrin me te madh e zene mosfillimet e vendosura per referimet e bera per vepren penale te parashikuar nga neni 150, gjithsej 21 mosfillime, ato per vepren penale te parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, gjithsej 6 mosfillime, ato te vendosura per kundravajtjen penale te parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, gjithsej 19 mosfillime, ato te vendosura per vepren penale te parashikuara nga neni 290/1 gjithsej 14 mosfillime, per vepren penale te parashikuar nga neni 151 gjithsej 7 mosfillime, per vepren penale te parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal gjithsej 12 mosfillime, per vepren kundravajtjen te parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal gjithsej 18 mosfillime, per kundravajtjen penale te parashikuar nga neni 277 gjithsej 9 mosfillime si dhe 6 mosfillime per kundravajtjen penale te parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

Keta tregues te pasqyruar ne tabele dhe te krahasuar me treguesit e nje viti me pare rezultojne si me poshte.

Vitet	Neni 290/1	Neni 99	Neni 84	Neni 150	Neni 151	Neni 248	Neni 277	Neni 89	Neni 90
2019	19	17	19	18	16	18	12	2	22
2020	14	2	19	21	7	12	9	6	18



Ne te gjitha rastet, kur prokuroret kane vendosur mosfillimin e procedimit penal eshte bere njoftimi i vendimit personit apo subjektit qe ka bere kallezimin dhe personave ndaj te cileve eshte bere kallezimi.

Natyrisht ne gjykate jane administruar ankimime te kallezuesve dhe gjykata ne 6 raste ka vendosur shfuqizimin e vendimit te mosfillimit dhe ka udheruar regjistrimin e proçedimit penal.

Sipas prokuroreve keto vendime shfuqizimi ndahen: - 2 raste jane vendime te prokurorit B. Shehu, 2 raste eshte vendim i prokurores A. Prençi dhe 2 raste eshte vendim i prokurorit A. Nika. Ndaj ketyre vendimeve prokuroret kane bere ankime ne Gjykatën e Apelit por nga rastet e gjykuara nga kjo gjykate nuk eshte ndryshuar vendimi i gjykates se shkalles se pare ne favor te ankimit te prokurorit.


Gjate vitit 2020 nga Prokuroret e kesaj Prokurorie, u ndoqen ne hetim 815 procedime penale regjistruar rishtazi dhe te mbartura nga vitet e pararendese.

Gjate hetimit te ketyre proçedimeve jane marre me cilesine e personit nen hetim 288 persona dhe ne perfundim jane marre me cilesine e te pandehurit 248 persona. Me masen e arrestit ne burg per kete vit jane ndjekur 102 te pandehur.

Krahasuar me vitin 2019, keto tregues per vitin 2020 jane me te larte.

Per vitin 2019 jane ndjekur ne hetim 644 proçedime penale, jane marre nen hetim 122 persona, jane marre te pandehur 236 persona dhe jane ndjekur me masen e sigurimit arrest ne burg 181 te pandehur.

Vitet	Proçedime hetuar	Persona nën hetim	Të pandehur	Me mase sig 238
2019	644	122	236	181
2020	815	288	248	102



Gjate vitit 2020, rezultojn se është dhënë zgjidhja ligjore për 611 procedime penale, me 70 persona nën hetim, 238 të pandehur, nga të cilët 76 janë ndjekur me masën e arrestit në burg. Krahasuar me vitin 2019, këto tregues kanë këtë paraqitje.


Është dhënë zgjidhje ligjore për 405 procedime, me 26 persona nën hetim, me 226 të pandehur, 104 prej të cilëve janë ndjekur me masën e sigurimit "arrest në burg".

Në mbyllje të vitit 2020 kanë mbetur në hetim 204 procedime penale, me 218 persona nën hetim, 10 të pandehur, 26 me masën e sigurimit "arrest në burg".

Këto tregues për vitin 2019 rezultojn të jenë: 241 procedime të mbartura me 96 persona nën hetim, 10 të pandehur, 77 me masën e sigurimit "arrest në burg".

Vitet	Zgjidhur	P/hetim	Pand	A/ burg	Mbartur	P/hetim	Pandehur	A/ burg
2019	405	26	226	104	239	96	10	77
2020	611	70	238	76	204	218	10	26

ZGJIDHJET LIGJORE



Vepra penale me perhapje me te gjere edhe per vitin 2020 vazhdon te mbetet ajo e vjedhjes, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

Gjate vitit 2020 u regjistruan 244 procedime penale per veper penale te parashikuar nga neni 134 i Penal (perfshire dhe rifillimet), 132 procedime me shume se ne vitin 2019.

Ne teresi ju eshte dhene zgjidhje 227 procedimeve penale te regjistruara per kete veper penale, ku per 138 procedime penale eshte vendosur pezullimi i hetimeve dhe eshte kerkuar pushimi i hetimeve per 84 procedime penale.

Gjate vitit 2020 jane derguar per gjykim 5 procedime penale te rregjistruar per kete veper penale, me 6 te pandehur, nga te cilet 4 me masen e sigurimit "arrest ne burg".

Per vitin 2019, rezulton se per kete veper penale jane zgjidhur 136 procedime penale, ku per 125 procedime eshte vendosur pezullimi i hetimeve, transferuar 1 procedime dhe derguar ne gjykate 9 procedime penale.

Por, ndersa vjedhja eshte krimi me perhapje me te madhe dhe me tendence rritje, zbulueshmeria e autoreve te kesaj vepre penale eshte mjaft e ulet. Pergjithesisht, procedimet per kete veper penale relatohen ne Prokurori pa autor, apo pa dyshime konkrete per autor te mundshem. Edhe nga hetimi me pas nuk sigurohen te dhena per autoret e veprave penale, dhe ne perfundim te hetimeve, relatohet pezullimi i procedimeve penale per moszbulim te autoreve.

Renie per vitin 2020 ka shenuar, vepra penale "Ndertimi i paligjshem", parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Gjate vitit 2020 u regjistruan 33 procedime penale per kete veper, nga 46 procedime qe ishin regjistruar per vitin 2019.

Vepra penale "Dhuna ne familje" parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, ka qene ne te njejtat nivele si nje vit me pare. Per kete veper u regjistruan 20 procedime penale nga 20 procedime qe ishin regjistruar gjate vitit 2019.


Vepra penale "Shkaterrimi i prones me zjarr", parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal nuk ka pesuar ndryshim te dukshem gjate vitit 2019. U regjistruan 5 procedime penale per kete veper nga 4 qe ishin regjistruar ne vitin 2019.

Nderkohe vazhdojne te kene numer te larte edhe procedimet penale te regjistruara per veprat penale "Drejtimi i automjeteve ne menyre e parregullte", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, 55 procedime penale, vepra penale "Shkelja e rregullave te qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, 15 procedime penale, vepra penale "Kultivimi i bimeve narkotike", parashikuar

nga neni 284 i Kodit Penal, 13 procedime penale dhe vepra penale e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, 20 procedime penale.

Tabela me poshte pasqyron treguesit per keto vepra penale te vitit 2020 krahasuar me treguesit e vitit 2020.

Viti	Neni 134	Neni 130/a	Neni 199/a	Neni 290	Neni 291	Neni 283	Neni 284	Neni 151
2019	132	20	46	38	32	18	16	4
2020	244	20	33	15	55	20	13	5



Tregues te tjere te efektivitetit te ndjekjes penale.

Treguesit qe analizuan me siper, flasin per efektivitet te ndjekjes penale, ne kuptimin jo vetem te perballimit te nje ngarkese dhe volumi te madh pune, por edhe ne dhenien e zgjidhjeve te drejta e te bazuara ne ligj dhe brenda afateve ligjore.

Gjate vitit 2020, eshte vendosur pushimi i hetimeve per 206 procedime penale.

Nder procedimet penale per te cilat eshte kerkuar pushimi i hetimeve kane qene 66 persona nen hetim.

Ne kete tregues, ritheksojme rritjen e tij per shkak 82 procedimeve penale te rifilluara rregjistruar per vepren penale te parashikuar nga neni 134 i K.Penal dhe kerkuar pushimi i tyre per shkak te konstatimit te parashkrimit te ndjekjes penale.

Pushimi i hetimeve rezulton se eshte vendosur per 7 procedime penale te regjistruara per vepren penale "Shkelja e rregullave te qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal me 7 persona nen hetim, per 3 procedime penale te regjistruara per vepren penale "Ndertimi i paligjshem", parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Pushimi i hetimeve eshte vendosur per 2

proçedime te rregjistruara per vepren penale "Dhuna ne familje". Pushimi i hetimeve eshte vendosur per 15 proçedime te rregjistruar per vepren penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikeve ", parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, per 1 proçedim te rregjistruar per vepren penale "Shperdorimi i detyres", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, per 2 proçedime penale te rregjistruara per vepren penale " Organizimi i llotarive te palejuara", parashikuar nga neni 197, per 15 proçedime penale te rregjistruara per vepren penale "Drejtimi i automjeve ne menyre te parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal me 15 person nen hetim, etj.

Ne te gjitha rastet, kur pushimi i hetimeve eshte vendosur nga prokurori, vendimi i pushimit ju eshte njoftuar personave te interesuar, kallezuesit, personit nen hetim, personave te demtuar, si dhe Komisarariatit te Policise Kurbin e Drejtorise Vendore te Policise Lezhe kur keto subjekte kane qene referues te materialeve.

Gjate vitit 2020, nuk evidentohen raste qe gjykata ka shfuqizuar vendimet per pushimin e hetimeve te vendosura nga prokuroret, por jane evidentuar dy raste qe Gjykata mos kete miratuar kerkesat per pushimin e çeshtjes per vepren penale te parashikuar nga neni 290 i K.Penal.

Pamvarsisht mos dakortesise me vendimmarrjen e Gjykates, ne kushtet kur ndaj vendimit nuk ushtrohet ankim, eshte vijuar me kryerjen e veprimeve te urdheruara nga Gjykata kryesisht kryerjen e riekspertimeve autoteknike.

Gjate vitit 2020, objekt te kesaj analize, rezulton nga te dhenat statistikore se nga ana jone jane derguar per gjykim ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kurbin 218 proçedime penale, me 224 te pandehur, 67 prej te cileve me masen e sigurimit arrest ne burg.

Proçedimet e derguara per gjykim perbejne rreth 35.6 % te zgjidhjeve te dhena ne kete prokurori per vitin 2020, duke perfshire ketu proçedimet e pezulluara, te pushuara dhe ato te transferuara prokurorive te tjera.

Krahasuar me vitin 2019, numri i proçedimeve te derguara per gjykim, ne statistike rezulton te jete me i larte me 21 proçedime penale. Gjate vitit 2019 u derguan per gjykim 197 procedime penale me 224 te pandehur, 101 prej te cileve jane ndjekur me masen e sigurimit "arrest ne burg".

Treguesi i proçedimeve penale te derguara per gjykim gjate vitit 2020, shpjegohet dhe me proçeduren e zgjatur pas ndryshimeve te Kodit te Procedures Penale, dhe me faktin se per nje numer proçedimesh per te cilet prokuroret kishin konkluduar per dergimin ne gjykim, deri ne mbyllje te vitit 2020, Gjykata nuk kishte shqyrtuar te gjitha kerkesat per dergimin e proçedimeve per gjykim.

Nga ana tjeter, vleresoj se ne teresine e ceshtjeve penale te zgjidhura per vitin 2020, numri i çeshtjeve te derguara gjykates per gjykim perben rreth 36.5% te numrit te tyre, tregues ky per tu vleresuar, qe tregon perkushtimin e Prokuroreve ne ushtimin e funksioneve te tyre.

Keshtu, ne gjykate rezulton se u derguan 150 kerkesa per dergimin e çeshtjes per gjykim dhe deri ne perfundim te vitit nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kurbin u shqyrtuan 126 kerkesa, duke mbetur te pashqyrtuara 24 kerkesa te tjera.

Gjithashtu prokuroret kane aplikuar dhe institutet e reja proçeduriale penale "Marreveshje e pranimit te fajsize" si dhe "Urdherit penal".

Gjate ketij viti nga ana e Prokuroreve, i eshte kerkuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin, miratimi i marreveshjes se fajesise per 61 çeshtje, nga te cilat pas shqyrtimit te tyre, Gjykata ka miratuar 61 raste.

Sa i perket institutit tjetër "Urdherit penal", nga ana jone eshte aplikuar ky institut gjate ketij viti ne 7 raste, te cilat pas shqyrtimit gjyqesor, Gjykata ne 7 prej tyre ka vendosur miratimin e urdherit.

Lidhur me aplikimin e ketyre dy instituteve, vleresojme se duhet te aplikohet me shume, kjo per shkak te efektivitetit te tyre, proçedurave te shkurtra hetimore dhe gjyqesore, kjo referuar dhe mbingarkeses aktuale te Prokuroreve ne hetim.

Dhe per keto institute, jane hasur veshtiresi dhe problematike, ne zbatimin e tyre. Verehet ngurrim i paleve per kerkimin dhe aplikimin e gjykimit me marreveshje, kryesisht per faktin se mbrojtja dhe te pandehurit kerkojne aplikimin e gjykimit te shkurtuar, gjykim kete te cilin e perfitojne ne Gjykate dhe nuk pasqyrohet nga Prokurori gjate hartimit te marreveshjes.

Interesi i te pandehurve dhe mbrojtjes per kete institut te ri gjykimi, shprehet ne kerkimet per caktimin ndaj te denuarve te denimeve alternative (neni 59 e 63 te K.Penal).

Gjate vitit 2020, rezulton se nga ana e Prokuroreve te kesaj Prokurorie, eshte aplikuar dhe gjykimi i drejtperdrejte.

Referuar te dhenave te statistikes eshte kerkuar Gjykates Kurbin gjykimi i drejtperdrejte per 16 proçedime, dhe pranuar prej saj ne 16 raste (ne statistike nuk jane evidentuar sakte). Ky lloj gjykimi eshte aplikuar kryesisht per vepren penale te parashikuar nga neni 291 te K.Penal.


Rreth ketij treguesi, vleresoj pune te mire te Prokuroreve te kesaj Prokurorie, por nevojitet aplikimi me i shtuar i tij. Ky lloj gjykimi, shmang zvarritjet e panevojshme, ngarkesen ne hetim, zgjidhjen ne kohe shume te shkurter te çeshtjes duke dhene drejtesi ne menyren me te shpejte.

Nga proçedimet e derguara per gjykim, numrin me te madh e zene proçedimet per vepren penale te parashikuar nga neni 291 te Kodit Penal, 44 proçedime per kete veper penale, 15 proçedime per vepren penale "Dhuna ne familje", parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, 29 proçedime per vepren penale te parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, 11 proçedime per vepren penale "Prodhim dhe shitje e narkotikeve" parashikuar nga neni 283 i K.Penal, 9 proçedime penale per vepren penale "Mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe e municionit", parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, 15 proçedime per vepren penale "Shkelja e rregullave te qarkullimit rrugor" parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, 4 proçedim per vepren penale "Kultivimi i bimeve narkotike", parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, etj .

Tabela pasqyron keta tregues te shenuar gjate vitit 2020 dhe ato te shenuara gjate vitit 2019.

Viti	Neni 291	Neni 290	Neni 130	Neni 199/a	Neni 278	Neni 284	Neni 283	Neni 137
2019	28	14	25	34	8	1	15	14
2020	44	15	15	29	9	4	11	15

PROÇEDIMET E DERGUARA PER GJYKIM



Keshtu prokuroret gjate vitit 2020 kane perfaqesuar akuzen ne gjykim ne 218 proçedime penale perfshire dhe proçedimet e mbartura ne gjykim nga vitet e meparshme, me 249 te pandehur, 68 prej te cileve kane qene me masen e sigurimit "arrest ne burg".

Numri i larte i proçedimeve ne gjykim per vitin 2020 dhe perballimi i ketij volumi ne gjykim, ka kerkuar angazhim te vazhdueshem te prokuroreve, planifikim dhe ndjekje me korrektese te seancave gjyqesore. Pjesemarrja e prokurorit ne gjykime ka qene e plote dhe efektive. Kjo ka bere qe per vitin 2020, te perfundoj gjykimi i 187 çeshtjeve penale, me 190 te pandehur, 75 prej te cileve kane qene me masen e sigurimit "arrest ne burg".

Duhet theksuar se pjesemarrja e prokurorit ne gjykim gjate vitit 2020 per shkak te ndryshimeve ne Kodin e Procedures Penale eshte shume me e madhe se numri i proçedimeve te gjykuara ne kete vit. Kjo per shkak se prokurori me ndryshimet e K.Pr.Penale, ne gjykimin e nje proçedimi merr pjese edhe ne seancat paraprake dhe me pas ne seancat gjyqesore. Pervec kesaj pjesemarrja e prokurorit tani eshte edhe per proçedimet qe dergohen per pushim, pra prokurori perfaqeson jo vetem akuzen ne gjykimin e proçedimeve penale te derguara per gjykim por edhe merr pjese dhe mbron kerkesat per pushimin e ceshtjeve penale te regjistruara per krime.

Perfaqesimi i akuzes ne gjykim per vitin 2020 duhet vleresuar pozitiv. Gjykata pergjithesisht ka gjetur te drejte dhe te bazuar ne ligj e prova akuzat e ngritura nga prokuroret dhe kerkesat e tyre.

Gjykata, gjate shqyrtimit gjyqesor ka ndryshuar kualifikimin ligjor per dy proçedime raste, te ankimuar nga ana jone.

Eshte vendosur pushimi per 4 proçedime dhe 3 pafajsi te akuzuar per kryerjen e veprave penale te parashikuara nga nenet 200, 199/a, 248, 283 te K.Penal. Nga keto raste per 5 prej tyre eshte ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane.

Gjate vitit 2020, nga prokuroret eshte kerkuar denimi me gjobe ne 27 raste dhe eshte dhene nga gjykata ne 27 raste, denimi me burgim ne minimum nga prokuroret eshte kerkuar ne 32 raste dhe eshte dhene nga gjykata ne 22 raste, denimi me burgim ne mesataren e dispozites eshte kerkuar nga

prokuroret ne 36 raste dhe eshte dhene nga gjykata ne 31 raste, denimi me burgim ne maximum eshte kerkuar ne 3 raste dhe eshte dhene nga gjykata vetem ne nje rast.

Nga prokuroret gjate vitit 2020 eshte kerkuar aplikimi i nenit 59 te Kodit Penal nga prokuroret eshte kerkuar ne 89 raste dhe eshte dhene nga gjykata ne 105 raste.

Ne lidhje me vendimmarrjen e Gjykates, ndryshe nga qendrimi yne, gjithsej gjate vitit 2020, nga prokuroret jane bere 59 apelime lidhur me themelin, llojin dhe masen e denimit dhe caktimin e masave te sigurimit. Kuptohet qe shume nga apelimet e bera nga prokuroret ende nuk jane shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe nuk kemi informacion nese jane pranuar. Ne 4 raste eshte perkrahur ankimi i Prokurorit lidhur me vlefesimin e arrestit dhe caktimin e mases se sigurise

Gjate vitit 2020, prokuroret kane paraqitur ne gjykate dhe shqyrtuar i nje numri te madh kerkesash te ndryshme penale 19 kerkesa per vlefesim e lejim pergjimi dhe zgjatje afati, kerkesa per kontroll banese, kerkesa per vendosje mase sekuestro, kerkesa per revokim vendimi, masa mjeksore. bashkim denimesh, lidhur me ekzekutimet etj.

Gjate vitit 2020, vemendje dhe kujdes i eshte kushtuar edhe caktimit te masave te sigurimit personal. Ne çdo rast kerkesa per caktimin e mases se sigurimit eshte bere duke vleresuar rrezikshmerine e vepres penale te autorit, tendencat dhe perhapja e vepres penale, e rrethana te tjera qe ka patur rasti.

Ne total gjate vitit 2020 jane ndjekur ne hetim 815 procedime penale, me 288 persona nen hetim dhe 248 te pandehur, nga te cilet 102 kane qene me masen e sigurimit arrest ne burg.

Gjate vitit 2020, arresti ne flagrance nga policia gjyqesore eshte vendosur per 86 persona. Prokurori ka kerkuar ne gjykate vleresimin e arrestit ne flagrance per 81 persona, duke kerkuar caktimin e mases se sigurimit arrest ne burg per 50 persona, ku ne kete numer perfshihen edhe 2 kerkesa per caktimin e arrestit ne burg ne mungese, dhe ne 31 raste ka kerkuar caktimin e mases se sigurimit detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore.

Gjykata ka vlefesuar te ligjshem arrestin ne flagrance dhe ndalimet, pra gjithsej 82 persona dhe ka caktuar per 45 persona masen e sigurimit arrest ne burg, per 5 persona ka caktuar si mase sigurimi ate te arrestit ne shtepi, ne 34 raste ka caktuar si mase sigurimi detyrimin per tu paraqitur ne policine gjyqesore.

Volumi i punes i perballuar nga prokuroret gjate vitit 2020 dhe zgjidhjet e dhena prej tyre.

Ne Prokurorine prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin gjate vitit 2020, funksionin e prokurorit e kane ushtruar prokurori Arben Nika, prokurori Bardhyl Shehu dhe prokurorja Ajola Prençi.

Keta prokurore kane drejtuar hetimin ne total te procedimeve penale te ndjekura gjate vitit 2020 dhe kane dhene zgjidhjet qe pasqyroam me siper.

Gjithashtu prej tyre eshte mbuluar edhe perfaqesimi i akuzes ne gjykim dhe gjithe marredhenia me gjykatën gjate ketij viti.

Ne menyre te detajuar volumin e punes te perballuar nga secili prej Prokuroreve te kesaj Prokurorie dhe zgjidhjet qe ata kane dhene po i pasqyrojme ne tabelen me poshte:

Prokuror	Proç	Mosfill	Trasf	Push	Pezull	Gjyq	Gj/ marr.	U/ penal	Shuma gjyq	Proç perf	Mbart
Arben Nika	253	81	0	52	60	28	45	3	76	188	65
Bardhyl Shehu	325	126	3	94	71	54	14	4	72	237	85
Ajola Prençi	237	100	4	60	49	68	2	0	70	179	54
TOTAL	815	307	7	206	180	150	61	7	218	604	204

Grafikisht, te dhenat per prokuroret parashtrihen si me poshte:





Tabela paraqet kerkesat e prokuroreve ne gjykate.

PROKURORI	K/Për pushim	Pushuar	K/Derg gjykim	Gjykim	K/ Miratim marrëveshje	Miratim	Urdhër Penal	Miratim
A. Nika	25	20	28	18	45	45	3	3
B. Shehu	34	30	54	51	14	14	4	4
A. Prençi	28	16	68	47	2	2	0	0
TOTALI	87	66	150	116	61	61	7	7

KERKESAT E PROKUROREVE NE GJYKATE



HETIMI DHE POLICIA GJYQESORE GJATE VITIT 2020.

Hetimi per vitin 2020, eshte mbuluar nga oficeret e policise gjyqesore te Prokurorise dhe nga oficeret e policise gjyqesore te Komisaritit te Policise e te Drejtorise Vendore te Policise Lezhe. Pergjithesisht, delegimi i procedimeve penale eshte bere sipas sugjerimit qe kane bere Komisaritati i Policise dhe Drejtoria Vendore e Policise Lezhe, duke u deleguar procedimet oficerëve qe kane referuar materialin dhe kane kryer veprimet kryesore proceduriale dhe hetimore. Ne disa raste sugjerimi per delegim eshte bere per oficeret e policise gjyqesore te Komisaritit qe mbulojne zonen ku ka ndodhur vepra penale, duke vleresuar ngarkesen e relatuar nga secili.

Ne seksionin e policise gjyqesore te struktures prane prokurorise, gjate vitit 2020 kane punuar oficeret e policise gjyqesore Nik Ndoci, Erenik Muhametaj. Oficeret e ketij seksioni, gjate vitit 2020, kane kryer veprimet verifikuese per nje pjese te madhe te materialeve ne fazen verifikuese si dhe kane ndjekur ne hetim procedimet penale te rregjistruara mbi kallezimet e qytetareve dhe procedime te tjera te referuara nga policia.

Por gjate vitit 2020, oficeret e policise gjyqesore te struktures se prokurorise krahas me hetimin jane ngarkuar edhe me detyra te tjera sipas nevojave qe ka diktuar puna ne sektor te ndryshem te Prokurorise.


Keshtu oficeri i policise gjyqesore Erenik Muhametaj eshte i ngarkuar dhe me administrim dhe nxjerrjen e te dhenave nga databazat shteterore.

Oficeri i Policise Gjyqesore Nik Ndoci, ka qene i komanduar per nje periudhe 6 mujore ne Prokurorine e Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kruje, deri me dt 21.07.2020, kur eshte rikthyer ne Prokurorine Rrethit Kurbin dhe krahas hetimit ka qene i ngarkuar edhe me trajtimin e komunikimit te akteve te autoriteteve te huaja te drejtesise, dhe ka qene kordinator per te drejten e informimit. Puna e policise gjyqesore e struktures prane prokurorise dhe e atyre prane Komisaritit

te Policise Kurbin dhe te Drejtorise Vendore te Policise Lezhe, vleresohet pozitivisht, jo vetem per dokumentimin e mire te veprave penale por edhe per hetimin me shpejtesi e pa zvarritje te procedimeve penale te ngarkuara.

Tabela me poshte pasqyron ngarkesen e oficerëve të policisë gjyqesore prane prokurorisë për vitin 2019.

O.P.GJ	Mosf.	Pezullim	Pushim	Transf	Gjykate	Hetim	Gjithsej
Nik Ndoci	30	0	9	1	20	20	50
Erenik Muhametaj	36	5	24		70	36	135



Ndjekja dhe ekzekutimi i vendimeve penale ka qene drejtim tjetër i rëndësishëm i punës tone për vitin 2020.

Ekzekutimi i vendimeve penale gjatë vitit 2020 është mbuluar nga prokurori Bardhyl Shehu. Po kështu urdherat e ekzekutimit janë nxjerre dhe nga prokurorët e çështjeve lidhur me masat e sigurimit si dhe denimet alternative të aplikuar nga Gjykata.

Gjatë këtij viti janë nxjerre 192 urdhera për ekzekutim të vendimeve penale të formës së prerë.

Nga këta, 28 urdhera për denime të dhëna me burgim, 26 urdhera për ekzekutimin e vendimeve me gjobe, 133 urdhera për ekzekutimin e vendimeve penale sipas nenit 59 të Kodit Penal dhe 6 urdhera për ekzekutimin e vendimeve në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal.

Gjate vitit 2020, jane ekzekutuar 28 vendime per denime me burgim, jane ekzekutuar 26 vendime me denim me gjobe, jane ekzekutuar (vene ne ekzekutim) 133 vendime me pezullim te ekzekutimit te denimit me burgim sipas nenit 59 te Kodit Penal, jane ekzekutuar 6 vendime denimi me aplikim te nenit 63 te K.Penal.

Gjate vitit 2019, prokurori Arben Nika ka ndjekur marredheniet juridiksionale me jashte.

Gjate ketij viti, jane derguar ne gjykate 3 kerkesa per njohje te vendimeve penale te gjykatave te huaja, te cilat jane shqyrtuar dhe pranuar nga gjykata sipas kerkeses se prokurorit. Po keshtu gjate vititi 2020, jane ekzekutuar 6 leter porosi nga jashte dhe jane derguar 9 kerkesa per ndihme juridike autoriteve te huaja te drejtesise.

Administrata e Prokurorise gjate vitit 2020.

Kryesekretarja znj Valbona Luli ka qene e ngarkuar me veprimtarine financiare te prokurorise. Administrimi i rregjistrave te proçedimeve penale dhe referimeve gjate ketij viti eshte bere nga sekretarja znj Luiza Pllumi, e cila ka administruar edhe Sistemin CAMS dhe ka mbajtur edhe statistikat elektronike.

Me administrimin e dokumentacionit, protokollit dhe arkivit ka qene e ngarkuar sekretarja znj Adelina Gjoni.

Rol ne mbarevajtjen e gjithë punes ne Prokurori gjate vitit 2020 kane patur edhe punonjesit e tjere te administrates, sekretaret Adelina Laska, kordinatorja Albana Malçi, Ardian Kosumi, shoferi Nikolin Gjetani dhe sanitarja Marjana Buzali.

Ushtrimi i rolit dhe kompetencave te Drejtuesit te Prokurorise.

Veprimtaria e prokurorise gjate vitit 2020 ne ushtrimin e ndjekjes penale dhe perfaqesimin e akuzes ne gjykim, natyrisht qe eshte e lidhur edhe me rolin e Drejtuesit te Prokurorise ne kete veprimtari.

Nga ana ime si drejtues i kesaj prokurorie krahas ngarkeses se punes hetimin, gjykimin dhe kerkesat me autoritetet e huaja, eshte ndjekur dhe kontrolluar ne vijimesi e gjithë veprimtaria e Prokurorise, duke kerkuar ne çdo rast zbatimin e drejte te ligjit material dhe atij proçedural penal.

Jam perpjekur te zbatoje te gjitha detyrimet ligjore qe Drejtuesit te Prokurorise ia ngarkon Ligji Nr. 97/2016 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise" dhe detyrimet e tjera te Kodit te Proçedures Penale.

Kam vleresuar vazhdimisht si moment te rendesishem venien ne levizje me shpejtesi te kallezimeve dhe proçedimeve penale, duke caktuar menjehere pas shortimit te materialeve, oficerin e policise gjyqesore te ngarkuar me hetimin dhe duke ja kaluar pa vonese materialin prokurorit perkates. Kontrolli ne dinamike i ushtrimit te ndjekjes penale ka qene nje nga drejtimet e rendesishme te punes time si Drejtues i Prokurorise.

Me koleget, kemi diskutuar vazhdimisht, si me kerkesen time ne rastet kur eshte vleresuar e nevojshme por edhe me kerkesa te tyre per proçedime te ndryshme qe ata kane patur ne ndjekje per probleme te ndryshme qe kane rezultuar ne hetim.

Per te gjitha procedimet qe kane patur problematike te ndryshme hetimi apo ne perfundim te hetimeve, eshte diskutuar lidhur me gjendjen e hetimit, te provave te grumbulluara dhe per zgjidhjen ligjore te tyre.

Per shkak te kesaj praktike pune, gjate periudhe objekt analize viti 2020 nuk jam gjendur para situatave per te urdheruar me shkrim kryerjen e veprimeve per ndonje procedim penal, por kemi konkluduar ne çdo rast per veprimet e tjera te nevojshme qe duheshin kryer, ne rastet kur jane evidentuar te tilla.

Sipas rasteve nga ana ime si drejtues eshte bere zevendesimi i prokuroreve si per shkak te levizjes se prokuroreve ne kete prokurori, por edhe ne rastet e shqyrtimit te kerkesave per zevendesim te tyre, duke arsyetuar ne çdo rast shkaqet dhe arsyet dhe njoftuar paralelisht palet kerkuese.

Objekt i rendesishem i punes time ka qene veprimtaria e policise gjyqesore, si e seksionit prane prokurorise ashtu edhe e policise gjyqesore te strukturave te policise se shtetit.

Ne vijimesi kam organizuar takime me drejtuesit e Drejtorise Vendore te Policise Lezhe dhe te Komisarariatit te Policise Kurbin lidhur me trajtimin e rasteve te ndryshme dhe problematikave te hasura gjate hetimit.

Keto takime kane qene per ngjarje te ndryshme me impakt shoqeror qe per rrethin e Kurbinut jane te shpeshta, veçanerisht ato qe kane te bejne me krimin kunder jetes, ashtu edhe per probleme te ndryshme qe jane evidentuar lidhur me funksionimin e policise gjyqesore ne ndjekjen penale. Vleresoj se kjo praktike pune ka mbajtur te angazhuar me hetimin jo vetem oficeret e policise gjyqesore te ngarkuar me te por edhe drejtuesit e policise, ku keta te fundit kane qene me aktiv dhe jane ndjere me me pergjegjesi per hetimin dhe rezultatin e tij.

Marredhenia me publikun dhe qytetaret ka qene nje tjetër drejtim qe kam vleresuar ne veprimtarine time. Eshte organizuar puna qe ata te marrin takim me personin qe rezultonte pergjegjes per problemin qe ata kane patur, duke administruar dhe zgjidhur ne kohe problemin e tyre.

Urdherat dhe udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem jane trajtuar dhe diskutuar ne takimet me prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore dhe ne vijimesi eshte ndjekur zbatimimi i tyre.

DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER KRIMINALITETIT PER VITIN NE VAZHDIM DHE REKOMANDIME.

Analiza e punes dhe treguesve te shenuar per vitin 2020 eshte edhe ne funksion te evidentimit te drejtimeve kryesore te punes dhe veprimtarise per vitin ne vazhdim 2021, duke percaktuar prioritetet kryesore dhe duke bere permiresimet e nevojshme.

Së pari, një ndër drejtimet kryesore të veprimtarisë së punës për vitin 2021 është ngritja e cilësisë së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve penale.

Cilësia në veprime pasqyron së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe Oficeri të Policisë Gjyqësore, duke e pasqyruar atë në përpilimin e akteve, formulimit dhe arsyetimit ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare si dhe përfaqësimit në Gjykatë.

Hetimi dhe gjithë veprimtaria e policise gjyqesore duhet shenoje permiresime te ndjeshme cilesore, pasi kjo lidhet direkt edhe me rezultatin e ndjekjes penale. Prokuroret, por veçanerisht oficeret e policise gjyqesore eshte e nevojshme te punojne per ngritjen e tyre profesionale, per njohjen me mire te ndryshimeve ne ligjin material dhe ate procedural penal, si dhe te metodave dhe teknikave

te hetimit per veprat e renda penale, ato te korrupsionit dhe te atyre qe rezultojne me perhapje te gjere.

Ndjekja ne vijemsi e hetimeve nga ana e prokuroreve, per te patur dijeni ne çdo moment per gjendjen e hetimit dhe te provave, si dhe per te nderhyre ne kohe per kryerjen e veprimeve te tjera qe dikton dinamika e hetimit, eshte drejtimi tjetër i rendesishem per veprimtarine e prokurorise per vitin ne vazhdim.

Natyrisht qe oficeret e policise gjyqesore duhet te mbajne ne dijeni prokurorin per veprimet qe ata kryejne, nepermjet komunikimve te vazhdueshme dhe informacioneve qe duhet te perpilojne ne rastet e procedimeve komplekse apo kur keto kerkohen nga prokuroret. Mbi keto informacione, prokurori duhet te orientoje drejt veprimtarine hetimore duke nxjerre edhe aktet e nevojshme procedurale per kryerjen e veprime specifike si, kontrole, pergjime etj.

Gjithashtu prokurori duhet te nxise policine gjyqesore per nje hetim dinamik, te shpejte dhe te gjithanshem. Prokurori duhet te evidentojë konkretisht dhe percjelle me informacione Drejtuesit te Prokurorise per problematika te veçanta dhe pengesa te ndryshme qe kane te bejne me menyren e funksionimit te organizimit te punes se veprimtarise hetimore, zvarritjet e pajustificueshme, etj.

PRIORITET E VEPRIMTARISE SE PROKURORISE PER VITIN 2020

Se pari, prioritet i veprimtarise se Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin do te vazhdoje te mbetet hetimi i procedimeve penale per veprat te pastrimit te produkteve te veprimtarise kriminale, ne fushen e narkotikeve, dhuna ne familje dhe per veprat penale kunder jetes dhe kunder prones, ku keto te fundit jane edhe me perhapje te gjere.

Natyrisht, ky prioritet do te kerkoje jo vetem angazhim me te mire te prokuroreve dhe oficerëve te policise gjyqesore, por do te kerkoje edhe permiresime te punes dhe praktikave qe ndiqen per keto hetime. Permiresime duhen bere ne drejtim te aplikimit te metadave proaktive te hetimit duke shtuar aplikimin e ketyre metodave dhe rregulluar kete aplikim, duke vleresuar ne çdo rast zbatimin e normimeve proceduriale per to.

Rritja e cilësisë së hetimit dhe kryerja e veprimeve hetimore brenda një afati kohor sa më të arsyeshëm.

Rritjen e rezultateve në drejtim të identifikimit dhe konfiskimit të pasurive me origjinë kriminale, në kuadër të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese, kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Hetimet pasurore, vlersoj se jane tjetër prioritet i Prokurorise per vitin ne vijim. Me krijimin e Prokurorise se Posaçme, kjo kompetence tashme eshte shtrire ne rrethet gjyqesore, dhe eshte nje sfide per ne dokumentimi dhe hetimi pasuror.

Trajnimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, me qëllimin rritjes së mëtejshme të aftësive profesionale, të qënurit sa më profesional dhe etikë, përmbushjen e detyrës me përkushtim dhe ndershmëri, me qëllim përmirësimin e vendimarrjes.

Respektimi i parimeve te procedimit te drejte, te barabarte e te rregullt ligjor, ne mbrojtje te drejtave, interesave dhe lirive te ligjshme te viktimave dhe deshmitareve, ashtu dhe te dyshuarve, personave nen hetim, pandehurve dhe te denuarve.

Prioritet i rendesishem i punes tone per kete vit ne vazhdim do te jete aplikimi me i gjere i institutive te reja penale “Marreveshjes se fajesise”, “Urdherit penal” dhe “Gjykimi i drejperdrejte”.

Keto institute, te parashikuar rishtazi ne K.Pr.Penale, dy te parat, ulin ndjeshem ngarkesen e punes se prokuroreve, japin zgjidhje ligjore te pranuar nga palet, duke shmangur zvarritjet ne hetim dhe gjykimdhe ulin kostot e hetimit dhe gjykimit.

Gjate ketij viti do vijoje te jete prioritet dhe respektimi i Kodit te Drejtesise Penale per te Mitur dhe i ndryshimeve ne Kodin e Proçedures Penale per hetimin e proçedimeve me te mitur te pandehur dhe viktima.

Prokuroret dhe veçanerisht prokurori i caktuar per hetimin e proçedimeve me te mitur duhet qe ne vazhdimesi te mbaje nen kontroll veprimet proçeduriale dhe ato hetimore me te mitur dhe te organizoje takime me oficeret e ngarkuar me keto hetime.

Kryerja e trajnimeve te vazhdueshme per njohjen e Kodit per te Mitur dhe te ndryshimeve ne Kodin e Proçedures Penale duhet te perfshije te gjithe prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore.

Organizimi i analizave te perbashketa me oficeret e policise gjyqesore dhe drejtuesit e policise gjyqesore te strukturave te policise se shtetit ne funksion te rritjes se zbulueshmerise te autoreve te veprave penale, do te jete prioritet tjeter i veprimtarise tone ne vazhdim.

Keto analiza dhe takime duhet te shoqerohen me percaktime te veprimeve konkrete qe duhen kryer, veçanerisht per proçedimet e pezulluara per vepra te renda penale me qellim grumbullimin e te dhenave per rifillimin e hetimit, identifikimin dhe venien para pergjegjesise penale te autoreve te tyre.

Ne funksion te realizimit te ketyre permirsimeve dhe te ndjekjes me sukses edhe te prioriteteve, gjykuar edhe nga numri i materialeve dhe referimeve qe pergjithesisht adminstrohen ne kete prokurori, numri i procedimeve penale qe trajtohen ne nje vit, si dhe ndjekja e gjithe veprimtarise tjeter administrative e proceduriale, ndjekja e ekzekutimit te vendimeve penale, marredhenieve juridiksionale me jashte, kerkojne vazhdimisht qe ne kete prokurori te jene ne ushtrimin e funksionit 4 prokuror aq sa dhe eshte organika.

Kjo ishte tabloja e punes se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Kurbin per vitin 2020, e cila mendojme se do te plotesohet edhe me tej, me diskutime e sugjerime, nga prokuroret, oficeret e policise gjyqesore si dhe te ftuarit.

DREJTUESI I PROKURORISE

ARBEN NIKA

